



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 35
Prishtinë, më 21 tetor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 21 TETOR 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Në fillim të mbledhjes, kryeministri i Kosovës, **Hashim Thaçi**, i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me veprimet e fundit të KFOR-it, EULEX-it, në koordinim me institucionet e Republikës së Kosovës, për vendosjen e plotë të rendit dhe të ligjit në pjesën veriore të Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson lart përkushtimin e vazhdueshëm të forcave të KFOR-it, të EULEX-it, që në kuadër të mandatit të tyre po përmbushin angazhimet për vendosjen e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë në pjesën veriore të vendit.

Kryeministri tha se në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dënon dhunën e ushtruar mbi ushtarët e forcës paqeruajtëse të KFOR-it, nga ana e pjesëtarëve të strukturave kriminale në veri.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 14 tetor 2011,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritet publiko-privat,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,
10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike,
12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore,
13. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor për transfer të mjeteve në mes programeve buxhetore,
14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
15. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës u paraqitën këta deputetë: Anton Quni, Liburn Aliu, Shaip Muja, Daut Haradinaj, Myzejene Selmani, Sasha Millosavleviq, Afërdita Berisha-Shaqiri, Glauk Konjufca, Ganimete Musliu dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Liburn Aliu**, i parashtoi pyetje ministrit të Bujqësisë, **Blerand Stavileci**, lidhur me pagesat e drejtpërdrejta të fermerëve dhe blegtorëve të Kosovës.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

Deputeti **Shaip Muja**, i parashtoi pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, **Dardan Gashi**, lidhur me dëmtimin e ambientit nga ana e Kompanisë Ferronikeli dhe Sharcemi.

Ministri Dardan Gashi nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

Deputeti **Shaip Muja**, i parashtoi pyetje ministrit të Drejtësisë, **Hajredin Kuçi**, lidhur me dënimet e kompanive Ferronikeli dhe Sharcemi për dëmtimin e ambientit.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

Deputeti **Visar Ymeri**, i parashtoi pyetje ministrit të Financave, **Bedri Hamza**, lidhur me aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj deputetit Ymeri.

Deputeti **Visar Ymeri**, i parashtoi pyetje ministrit të Infrastrukturës, **Fehmi Mujota**, lidhur me tejkalimin e çmimeve sipas kontratës nga ana e Konzorciumit Bechtel-Enka në ndërtimin e autoudhës.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj deputetit Ymeri.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 14 tetor 2011

Procesverbali i mbledhjes plenare, të mbajtur më 14 tetor 2011, u miratua pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit

Kryesuesi, Sabri Hamiti, i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2 dhe 3.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	55,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Siguri, Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e komisionit funksional e arsyetoi deputeti Fatmir Xhelili.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2 dhe 3.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	56,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Siguri, Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	50,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritet publiko - privat

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për partneritet publiko - privat dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e komisionit funksional e arsyetoi deputetja Safete Hadërgjonaj.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional dhe deputeti Bekim Haxhiu

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12 dh 13.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin 10, të propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	55,
Kundër-----	4,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për partneritet publiko - privat.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e komisionit funksional e arsyetoi deputetja Teutë Haxhiu.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	61,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media dhe Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e komisionit funksional e arsyetoi deputetja Lirie Kajtazi.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	66,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Punë të Jashtme ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raportin e komisionit funksional e arsyetoi deputeti Hydajet Hyseni.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	54,
Kundër-----	1,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Raportin e Komisioni funksional për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raportin e komisionit funksional e arsyetoi deputeti Sadri Ferati.

Lidhur me këtë raport, në emër të grupeve parlamentare diskutuan këta deputetë: Xhevahire Izmaqi, në emër të GP të PDK-së, Sadri Ferati, në emër të GP të KDK-së, Albana Gashi, në emër të GP VV, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së dhe Jeton Svirca, në emër të GP të KKR-së,

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	65,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, njëzëri, miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike.

12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transferin e mjeteve buxhetore dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Rekomandimin e komisionit funksional e arsyetoi deputetja Safete Hadërgjonaj.

Lidhur me këtë rekomandim diskutuan: Hamide Krasniqi, Naser Osmani, Visar Ymeri, Xhevdet Neziri dhe Myzejene Selmani.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	66,
Kundër-----	1,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike: Investime Kapitale-Programi i Administratës Qendrore (kodi 229), nga projektet:
 - a. Riparimi i ndërtesës së APK-së dhe zyrave regjionale, (kodi i projektit 12429), në vlerë prej 30.000 €, dhe
 - b. Zhvillimi i softuerit për administrimin financiar të fondeve në mirëbesim (kodi i projektit 11194), në vlerë prej 45.000 €, në kategorinë ekonomike: Mallra dhe shërbime- Programi i Likuidimit (kodi 227), në vlerë prej 75.000€.

13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor për transfer të mjeteve në mes programeve buxhetore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për transferin e mjeteve buxhetore dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Rekomandimin e komisionit funksional e arsyetoi deputetja Safete Hadërgjonaj.

Lidhur me këtë rekomandim diskutuan: Hamide Krasniqi, Naser Osmani, Liburn Aliu, Xhevdet Neziri dhe Myzejene Selmani.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	65,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor për transferin e mjeteve, nga

- Programi për Mbrojtjen e Mjedisit (kodi 436), kategoria ekonomike: Investime Kapitale, “Projekti i binjakëzimit të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit me Agjencionet mjedisore të Austrisë dhe Finlandës” (kodi i projektit 12709), në vlerë prej 50.000 €, në
- Programin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit (kodi 436), në kategorinë ekonomike: Mallra dhe shërbime, në vlerë prej 50.000 €.

14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Me propozim të kryetarit të Grupit parlamentar të PDK-së, Kuvendi këtë pikë e shtyu për mbledhjen tjetër.

15. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Kuvendi, me propozim të grupit parlamentar të LDK-së, mori këtë:

V E N D I M

Deputetja Kimete Bytyçi, emërohet anëtare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetit Ismet Beqiri, nga Grupi Parlamentar i LDK-së.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 14:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.